



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2, Nenin 25, Nenin 27, Nenin 30 dhe Nenin 34 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 38 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 03/L-201);
- Dispozitat e Nenit 2, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 dhe Nenit 34 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë
- Kërkesën për ndryshim/modifikim të licencës për gjenerim të energjisë elektrike për TC Kosova A, e datës 28.06.2013 të ndërmarrjes Korporata Energjetike e Kosovës –Divizioni i Gjenerimit “KEK SH.A.”-TC Kosova “B” , adresa: rruga “Nënë Tereza nr. 36, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës;

**në seancën e mbajtur me datë 06 shtator 2013, nxori këtë:**

## **VENDIM**

**NDRYSHOHET** licenca për prodhim të energjisë elektrike (KREU I) e dhënë Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SH.A.), Divizioni i Gjenerimit “TC Kosova A”, me numër licence ZRRE/Li\_05/12\_A. Të gjitha dispozitat tjera të Licencës mbesin në fuqi.

## **Arsyetim**

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 28.06.2013 ka pranuar nga KEK SH.A Kërkesën për ndryshim/modifikim të licencës për prodhim të energjisë elektrike të KEK Sh.a. – Divizioni i Gjenerimit “TC Kosova A”, të bërë në pajtim me Nenin 38 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 03/L-201).
  - o ZRRE ka ndryshuar/modifikuar KREUN I të licencës për prodhim të energjisë elektrike të KEK SH.A-së “TC Kosova A”, duke i lejuar të licencuarit që të importojë energji elektrike të nevojshme për plotësimin e nevojave të konsumatorëve të pakualifikuar, në periudha kohore kur prodhimi vendor është i pamjaftueshëm, dhe kur në mungesë të këtyre importeve, konsumatorët do t’i nënshtrohen shkyçjes. Ky obligim do të shfuqizohet në pajtim me Nenin 38, paragrafin 3 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
  - o ZRRE duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- I.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.



II. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

*\*Bashkëngjitur Licenca e Modifikuar*

Vendimi i dërgohet:

- Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SH.A)
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar